



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT**

*Adresa: Rr “Reshit Çollaku”/ Pranë ILDKP, Tiranë*

*Tel: 042 220 466 / 499 Site: [www.kkk.gov.al](http://www.kkk.gov.al) E\_mail: [kontabiliteti@kkk.gov.al](mailto:kontabiliteti@kkk.gov.al)*

**RAPORTI**

**i**

**VEPRIMTARISË**

**Viti 2022**

*Mars 2023*

## **P Ë R M B A J T J A**

### **1. Hyrje**

### **2. Aktivitetet kryesore të vitit 2022**

### **3. Informacion i detajuar mbi detyrat e realizuara në vitin 2022**

- *Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*
- *Standardet Kombëtare të Kontabilitetit*
- *Detyra të tjera:*
  - ngarkuar nga Këshilli
  - në kuadër të Planit Kombëtar të Integritimit për Raportimin Financiar në Shqipëri
  - të ndryshme administrative

### **4. Plani i punës për vitin 2023**

### **5. Çështje të tjera për rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të punës së KKK-së**

*Shtojcë A - Realizimi i treguesve të buxhetit 2022*

*Shtojcë B - Buxheti i planifikuar për vitin 2023*

*Shtojcë C – Pasqyrat financiare 2022*

## SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jomateriale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
BE	Bashkimi European
BMP	Bordi i Mbikqyrjes Publike
BSNK	Bordi i Standardeve të Kontabilitetit
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
IKM	Instituti i Kontabilistëve të Miratuar
KKK	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
NVM	Njësi ekonomike të Vogla dhe të Mesme
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin European
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

## 1. Hyrje

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, organizëm profesional, publik dhe i pavarur, ka si mision përmirësimin e vazhdueshëm të raportimit financiar të njësive ekonomike fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Ky mision, i zërthyer në objektiva të qarta, strategji të përshtatshme dhe plane pune të koordinuara, garanton transparencën dhe saktësinë e raportimeve financiare si kusht i panegociueshëm i cilësisë së vendimeve ekonomike të operatorëve të tregut.

Tre produktet kryesore që realizon KKK-ja, në kuadër të detyrave të ngarkuara nga ligji i kontabilitetit, janë:

- hartimi dhe përmirësimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit;
- përkthimi, pa ndryshime nga teksti origjinal dhe në kohë reale, i SNRF-ve;
- monitorimi i zbatueshmërisë së standardeve të raportimit financiar

Gjithashtu, si një organizëm rregullator në fushën e raportimit financiar, KKK përpunon sistemin dhe metodat kontabël. Në rast se është një nevojë e përdoruesve apo hartuesve të raporteve financiare, KKK formulon edhe udhëzimet përkatëse kontabël. KKK me ligj ka detyrimin të kontribuojë me mendime dhe sygjerime në hartimin apo ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, me propozime konkrete për kurrikulat universitare që mbulojnë fushën e kontabilitetit si dhe të publikojë materiale informuese dhe udhëzuese në zbatim të standardeve të raportimit financiar.

Në vitin 2022 KKK mori vendimin për një rishikim të thelluar të SKK-ve për t'i bërë ato të pajtueshme me kërkesat e SNRF për NjVM. Bashkë me Standardet janë rishikuar edhe Udhëzuesit në zbatim të tyre.

Paralelisht me hartimin dhe përditësimin e SKK-ve është realizuar me shumë përpikmëri dhe përkthimi i SNRF-ve dhe publikimi mbi baza vjetore i variantit të konsoliduar të SNRF-ve në gjuhën shqipe. Njësitë ekonomike të cilat kanë detyrimin të hartojnë pasqyra financiare sipas SNRF-ve kanë mundësinë (*minimalisht 1 vit para datës së zbatimit të detyrueshëm të tyre*), t'i gjejnë ato të publikuara në gjuhën shqipe në faqen zyrtare të KKK-së.

Në kuadër të procesit të integritetit, KKK-ja ka kontribuar me përgatitjen e materialeve të kërkuesve nga Shërbimet e Komisionit Europian në lidhje me çështjet e raportimit financiar, si një çështje e rëndësishme e progresit për Shqipërinë.

## **1. Statusi, detyrat dhe organizimi**

### ***1.1 Statusi***

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit financohet nga buxheti i shtetit. KKK ka të drejtë të përdorë edhe të ardhurat që realizon nga punët që kryen. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Pjesë të këtij raporti ku trajtohen me hollësi edhe problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda po këtij afati.

### ***1.2 Detyrat***

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë:

- a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- b) të përpunojë një sistem kontabël, ku, përveç standardeve kombëtare të kontabilitetit, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, si dhe formatet për pasqyrat financiare;
- c) të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;
- ç) të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;
- d) të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;
- dh) të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin;
- e) të publikojë në faqen zyrtare të institucionit Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, ka të

drejtën të publikojë edhe materiale të tjera, jo të detyrueshme për zbatim, me karakter dhe qëllim informues, në funksion të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;

ë) të botojë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standarde;

f) të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar;

g) të organizojë tryeza të rumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës përmes përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt të SKK-ve/SNRF-ve nga njësitë ekonomike.

### ***1.3 Përbërja dhe organizimi***

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 7 anëtarë, prej të cilëve:

- a) një anëtar propozohet nga organizata profesionale e auditimit ligjor;
- b) një anëtar propozohet nga shoqatat profesionale të kontabilitetit;
- c) një anëtar propozohet nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose njësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave;
- ç) tre anëtarë propozohen nga ministria përgjegjëse për financat, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave;
- d) një anëtar propozohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit mandatohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe kanë mandat 4-vjeçar. Ata mund të rimandatohen vetëm një herë me miratimin e ministrit përgjegjës për financat.

Kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit duhet të jenë persona me edukim në fushën e kontabilitetit dhe/ose financës, si dhe ekspertë në teorinë dhe metodologjinë e kontabilitetit ose praktikues në fushën e kontabilitetit. Për realizimin e detyrave, anëtarët angazhohen me kohë jo të plotë pune.

Veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit e mbështet një strukturë administrative me personel të punësuar. Struktura, organika, pagat për të punësuarit dhe honoraret e anëtarëve të këtij këshilli miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Organizimi dhe funksionimi i KKK, kërkesat e posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i këshillit, procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, procedurat për hartimin e standardeve kontabël kombëtare dhe të produkteve të tjera, të realizuara nga anëtarët e këtij këshilli ose të tretët, përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së funksionimit dhe organizimit të KKK-së”. Kryetari dhe nënkryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit zgjidhen nga anëtarët e këshillit, sipas procedurave të përcaktuara në rregullore.

## 2. Detyrat e realizuara në vitin 2022

Detyrat për vitin 2022, miratuar nga KKK-ja dhe statusi i realizimit të tyre, paraqiten si më poshtë:

<b>DETYRAT</b>	<b>Statusi i realizimit</b>	<b>Nr</b>	<b>Periudha</b>
• Analiza e veprimtarisë dhe buxhetit për vitin 2021;	Realizuar	1	28 Janar
• Prezantimi, diskutimi dhe miratimi i programit të punës për vitin 2022;	Realizuar		
• Miratimi i përdorimit të buxhetit 2021 dhe miratimi i zërave të buxhetit për vitin 2022;	Realizuar		
• Prezantimi, diskutimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të Veprimtarisë 2021;	Realizuar	2	10 Mars
• Prezantimi i projektit për rishikimin e thelluar të SKK-ve dhe përafrimin e tyre të mëtejshëm me SNRF për NjVM-të;	Realizuar		
• Analiza dhe diskutimi për ndryshimin e SKK 15 (për heqjen nga Standardi të kriterëve që përcaktojnë mikronjësitë);	Realizuar		

<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza për projektin e kalimit në formatin XBRL të pasqyrave financiare të publikueshme;</li> </ul>	Realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 4 <i>Inventarët</i> (matrica krahasuese me Section 13 <i>Inventarët</i>) - Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar	3	29 Mars
<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza dhe diskutimi për propozimin e termave të referencës për mbështetje me asistencë nga programi REPARIS;</li> </ul>	Realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 14 <i>Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta</i> (matrica krahasuese me Seksionin 14 <i>Investments in Associates</i> dhe Seksionin 15 <i>Investments in Joint Ventures</i>) - Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar	4	26 Prill
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 13 <i>Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare</i> (matrica krahasuese me seksionin 34 <i>Aktivite të specializuara të SNRF për NjVM</i>) - Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar	5	27 Maj
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 10 <i>Grantet dhe format e tjera të ndihmës</i> (matrica krahasuese me Seksionin 24 <i>Governments Grants të SNRF për NjVM</i>) – Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Takim me OJF-të (me synim harmonizimin e mëtejshëm të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi);</li> </ul>	Pa realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi dhe publikimi i variantit të konsoliduar të SNRF-ve, 2022;</li> </ul>	Realizuar	6	24 Qershor
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i> (matrica krahasuese me Seksionin 11 <i>Basic Financial Instruments</i> dhe Seksionin 12 <i>Other Financial Instrument Issues</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 8 <i>Të ardhurat</i> (matrica krahasuese me Seksionin 23 <i>Revenues</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar		



<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 5 <i>Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale</i> (matrica krahasuese me Seksionin 17 <i>Property, Plant and Equipment</i> Seksionin 18 <i>Intangible Assets other than Goodëill</i> Seksionin 25 <i>Borrowing Costs</i> dhe Seksionin 27 <i>Impairment of Assets</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar	7	14 Korrik
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 7 <i>Qiratë</i> (matrica krahasuese me Seksionin 20 <i>Leases</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza dhe diskutimi mbi nevojën e rregullimeve kontabël në sektorin e industrisë nxjerrëse dhe minerare;</li> </ul>	Realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për mikronjësitë “Caktimi i kufirit të poshtëm të detyrueshëm për zbatim në hartimin dhe publikimin e pasqyrave financiare”;</li> </ul>	Realizuar	8	21 Shtator
<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza dhe diskutimi për ndryshime të komentarit “Për plotësimin e pasqyrave financiare sipas SKK-ve”;</li> </ul>	Realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Workshop në bashkëpunim me Price Waterhouse Coopers “Për zbatimin e detyrueshëm të SNRF-ve”</li> </ul>	Pa realizuar		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 6 <i>Provizionet</i> (matrica krahasuese me Seksionin 21 <i>Provisions and Contingencies</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar	9	19 Tetor
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 9 <i>Kombinimet e biznesit dhe pasqyrat e konsoliduara</i> (matrica krahasuese me Seksionin 9 <i>Consolidated and Separate Financial Statements</i> dhe Seksionin 19 <i>Business Combinations and Goodwill</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>			

<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 11 <i>Tatimi mbi fitimin</i> (matrica krahasuese me Seksionin 29 <i>Income Tax</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 12 <i>Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit</i> (matrica krahasuese me Seksionin 30 <i>Foreign Currency Translation</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 1 <i>Kuadri për paraqitjen e pasqyrave financiare</i> (matrica krahasuese me Seksionin 2 <i>Concepts and Pervasive Principles</i> Seksionin 10 <i>Accounting Policies, Estimates and Errors</i> Seksionin 32 <i>Events after the End of the Reporting Period</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar	10	7 Nëntor
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i SKK 2 <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i> (matrica krahasuese me Seksionin 2 <i>Financial Statement Presentation</i> Seksionin 4 <i>Statement of Financial Position</i> Seksionin 5 <i>Statement of Comprehensive Income and Income Statement</i> Seksionin 6 <i>Statement of Changes in Equity and Statement of Income and Retained Earnings</i> Seksionin 7 <i>Statement of Cash Flows</i> Seksionin 8 <i>Notes to the Financial Statements</i> të SNRF për NjVM) – Faza e parë;</li> </ul>	Realizuar	11	23 Nëntor
<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza dhe diskutimi i afateve të adoptimit të SNRF për SME përkundrejt SKKve (1-14);</li> <li>Diskutimi për rimandatimin e Komitetit të Rishikimit;</li> <li>Analiza dhe diskutimi për programin e aktiviteteve të vitit 2023;</li> </ul>	Realizuar	12	12 Dhjetor

Një përmbledhje e aktiviteteve dhe detyrave të përmbushura është si më poshtë:

- Varianti i konsoliduar 2022 i SNRF-ve
- Varianti i rishikuar 2022 i SKK-ve (draft)
- Udhëzuesit e rishikuar të 14 SKK-ve – Drafti i parë

Të tjera detyra të realizuara gjatë kësaj periudhe nga stafi i KKK-së janë:

1. Koordinimi i punës për përkthimin e ndryshimeve 2022 të SNRF-ve, paraqitja për miratim në Këshill dhe përgatitja e dosjes shoqëruese në dërgimin e tyre për shpallje nga Ministri i Financave;
2. Raportimi periodik për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme (mbi informacionet e kërkuara nga Shërbimet e Komisionit Europian për Kapitullin 6 *Ligji Tregtar*);
3. Raportimi periodik për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me realizimin e detyrave institucionale dhe përfshirjen e tyre në kontributin për Progres Raportin për Shqipërinë;
4. Komunikimi me palë të interesuara për çështje të zbatimit të SKK-ve;
5. Të tjera administrative

### **3. Informacion i detajuar mbi detyrat e realizuara**

#### ***Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar***

##### ***a) Përkthimi i SNRF-ve***

Në vitin 2022 është përkthyer, rishikuar, miratuar në KKK dhe shpallur për zbatim me Urdhër Nr. 290<sup>1</sup>, datë 30.12.2022 dhe Urdhër Nr. 14<sup>2</sup>, datë 20.01.2023 të Ministrit përgjegjës për financat, materiali i publikuara nga BSNK gjatë vitit 2022, si më poshtë:

<sup>1</sup> [https://kkk.gov.al/foto/uploads/File/Urdher%20290\\_30122022%20Per%20ndryshimet%20e%20SNK%201](https://kkk.gov.al/foto/uploads/File/Urdher%20290_30122022%20Per%20ndryshimet%20e%20SNK%201)

<sup>2</sup> [https://kkk.gov.al/foto/uploads/File/Urdheri%2014\\_Per%20ndryshimin%20e%20SNRF%2016.pdf](https://kkk.gov.al/foto/uploads/File/Urdheri%2014_Per%20ndryshimin%20e%20SNRF%2016.pdf)

<b>Titulli</b>	<b>Data Efektive</b>	<b>Urdhri i Ministrit të MFE-së</b>
<b>Detyrimet Afatgjata me Premtime Kufizuese</b> <i>Ndryshime të SNK 1</i>	Më 1 janar 2024	Urdhër Nr. 290, datë 30.12.2022
<b>Detyrimi për Qiranë në një Shitje dhe Marrje më pas me Qira</b> <i>Ndryshime në SNRF 16</i>	Më 1 janar 2024	Urdhër Nr. 14, datë 20.01.2023

***b) Përgatitja e variantit të konsoliduar të SNRF-ve***

Në datë 3 mars 2022, BSNK në përputhje me termat e kontratës, dërgoi materialin *Red Book 2022*. Përgatitja e variantit të konsoliduar 2022 të SNRF-ve në gjuhën shqipe, u bë përmes programit TRADOS nga Inspektori për SNRF-të.

Si procedurë, në variantin e konsoliduar të vitit 2022 përfshihen SNRF-të e publikuara nga BSNK deri në dhjetor të vitit 2021. Varianti i konsoliduar 2022 përfundoi brenda muajit qershor 2022 dhe u dërgua për aprovim në BSNK. Me përjashtim të një ndërhyrje në formatimin e një tabele, gjithçka tjetër ishte në përputhje me kriteret e përcaktuara nga BSNK për publikimin e materialit.

Konfirmimi erdhi me email përpara mbledhjes së muajit qershor. Varianti i konsoliduar 2022 është publikuar në faqen e internetit të KKK-së<sup>3</sup>.

***Standardet Kombëtare të Kontabilitetit***

***a) Ndryshime të SKK 15***

Në vitin 2022, Këshilli miratoi ndryshimin e SKK 15, për sa i përket rregullimit për detyrimin e hartimit dhe publikimit të pasqyrave financiare të mikronjësive. Në SKK 15 u ndryshua paragrafi

<sup>3</sup> <https://kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=135&gj=sh>

5 dhe u fshi paragrafi 12 të cilët parashikonin kriteret e detyrueshme për zbatimin e këtij standardi. Me ndryshimet e miratuara, mikronjësitë nuk i referohen më SKK 15 përse i përket kriterëve që duhet të përmbushin për hartimin dhe publikimin e pasqyrave financiare por vetëm ligjit për kontabilitetin. Ky ndryshim ka datë efektive datën 1 janar 2028. Mikronjësitë pas vitit 2028, edhe nëse nuk tejkalojnë xhiron vjetore 5 mln lekë, duhet të hartojnë dhe publikojnë PF.

Për pasqyrat financiare të vitit 2028 e në vijim, mikronjësitë nuk janë më të lejuara që të mos hartojnë dhe publikojnë pasqyra financiare nëse nuk tejkalojnë xhiron vjetore prej 5 milion lekë.

#### ***b) Ndryshime të SKK -ve (2022)***

Në vitin 2022 është punuar për përmirësimin e setit të SKK-ve. Përmirësimi i fundit i plotë i SKK-ve është bërë në vitin 2014 dhe Këshilli e gjykoi të nevojshëm një përditësim dhe rishikim të thelluar të tyre. Gjithashtu, rishikimi dhe përmirësimi i setit të SKK-ve do të mbajë në konsideratë edhe rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Europian për vijimin me transpozimin e Dir 34/2013 të Kontabilitetit në EU në legjislacionin shqiptar.

Përmirësimi i SKK-ve u konceptua si një proces me tre faza. Qasja e ndjekur në fazën e parë, të parashikuar për t'u përmbyllur në vitin 2022 ishte përgatitja e matricave krahasuese mes secilit prej SKK-ve të përmirësuar (publikuar në dhjetor 2014) dhe kërkesave të seksionit/eve koresponduese të SNRF për NjVM. Nga matricat krahasuese u evidentuan kërkesat e SNRF për NjVM të pakonsideruara më parë në setin e SKKve si dhe kërkesat e SKKve që tejkalonin kërkesat e SNRF për NjVM. Çdo diferencë e evidentuar më pas u mor në analizë për shtesa, pakësime apo ndryshime duke gjykuar mbi efektet përkatëse në cilësinë e raportimit financiar të NjVM.

Faza e dytë, e parashikuar të përmbyllet në vitin 2023, parashikon rishikimin për shtesa apo ndryshime të SKKve me fokus kërkesat e Direktivave të BE për kontabilitetin, duke vlerësuar rast pas rasti ato kërkesa të këtyre Direktivave të pa konsideruara në momentin e hartimit të ligjit

25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe kur u miratuan ndryshimet e SKK 2 dhe SKK 9 të vitit 2019.

Faza e tretë, e parashikuar të përmbyllet gjatë vitit 2023, parashikon përgatitjen e draft SKK-ve të përmirësuara ku të jenë reflektuar të gjitha ndryshimet e sugjeruara nga KKK në fazën e parë dhe të dytë. Ky draft do të publikohet më pas për komente, në faqen zyrtare të internetit të KKK-së për një periudhë jo më të gjatë se 6 (gjashtë muaj).

### *Detyra të tjera*

#### ➤ **RAPORTI I VEPRIMTARISË 2021;**

a) **Raporti i veprimtarisë 2021.** Në ligjin e kontabilitetit, neni 27(1) dhe 27(2) parashikohet që Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Raporti, pjesa ku trajtohen me hollësi problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike, brenda afatit të pikës 1, të këtij neni.

Raporti i veprimtarisë 2021 u miratua në Këshill për t’u dërguar, brenda të gjitha afateve, tek ministri përgjegjës për financat dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Gjithashtu raporti i veprimtarisë u publikua<sup>4</sup> në faqen e internetit të KKK-së.

#### ➤ **GJETJET NGA MONITORIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2022**

##### ❖ *Gjetje nga monitorimi i pasqyrave financiare të hartuara për vitin 2020*

Në zbatim të kërkesës së ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” janë monitoruar gjithsej gjatë vitit 2022 pasqyrat financiare të 139 njësive ekonomike.

<sup>4</sup> <https://kkk.gov.al/faqe.php?id=9&l2=157&gj=sh>

Në gjashtë mujorin e parë janë monitoruar pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe në gjashtë mujorin e dytë, pasqyra financiare të vitit 2021. Kjo ndarje bëhet për arsye se pasqyrat financiare për vitin 2021 publikohen në portalin e QKB-së në tremujorin e dytë të vitit dhe jo më vonë se data 31 korrik.

Në 6-mujorin e parë, janë monitoruar pasqyrat financiare të vitit 2020të, gjithsej 66 njësive ekonomike. Pasqyrat financiare janë siguruar nga faqja zyrtare e QKB-së. Përzgjedhja e njësive ekonomike është bërë në mënyrë të rastësishme.

Forma juridike e njësive të kontrolluara është: 53 (pesëdhjetëetë) njësi ekonomike me status SHPK, 8 (tetë) njësi ekonomike me status SHA dhe 5 (pesë) njësi ekonomike me status Person Fizik. Ky klasifikim është bërë duke u bazuar në Ekstraktet Historike të subjekteve.

Nga 66 (gjashtëdhjetëegjashtë) njësi të marra në shqyrtim:

- 41(dyzetenjë) njësi ekomike kanë hartuar pasqyra fianciare për vitin 2020 duke përdorur SKK-të, SNRF-të dhe SKK 15;
- 25 (njëzetepesë) njësi ekonomike nuk rezulton të kenë të publikuara pasqyrat financiare në QBK.

Nga 41 (dyzetenjë) njësi ekonomike që kanë publikuar pasqyrat financiare:

- 6 (gjashtë) njësi ekonomike zbatojnë SNRF-të;
- 34 (tridhjetëekatër) njësi ekonomike zbatojnë SKK (1-14);
- 1 (një) njësi ekonomike zbaton SKK 15

**Tabelë 1. Standardet e zbatuara nga njësitë ekonomike - Klasifikimi sipas madhësisë**

	<b>Total Njësi</b>	E Madhe	E Mesme	E Vogël	Mikronjësi	Person Fizik
SKK	34	1	3	25	2	3
SNRF	6	5		1		
SKK 15	1			1		
<b>Total</b>	<b>41</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>27</b>	<b>2</b>	<b>3</b>

Në totalin e 25 njësive ekonomike që nuk kanë publikuar pasqyrat e tyre financiare në portalin e QKB-së rezulton se:

- 13 (trembëdhjetë) njësi ekonomike e kanë patur detyrim ligjor publikimin e pasqyrave në QKB dhe nuk e kanë respektuar. Forma juridike e tyre është: 8 (tetë) njësi ekonomike SHPK, 3 (tre) njësi ekonomike SHA dhe 2 (dy) njësi ekonomike Person Fizik;
- 4 (katër) njësi ekonomike kanë filluar aktivitet në vitin 2021 dhe do të rikontrollohen për pasqyrat 2021 nëse do të respektojnë detyrimin ligjor të publikimit;
- 2 (dy) njësi ekonomike kanë masën e sekuestros, forma juridike e tyre SHPK;
- 5 (pesë) njësi ekonomike kanë pezulluar aktivitetin pa afat, forma juridike e tyre SHPK;
- 1 (një) njësi ekonomike në likuidim e sipër, forma juridike SHPK.

### **Problematika gjatë monitorimit të pasqyrave financiare 2020**

Nga 41 (dyzetenjë) njësi ekonomike që kanë hartuar dhe publikuar Pasqyrat Financiare rezulton se 32 (tridhjetëedy) njësi ekonomike janë me status njësi ekonomike e vogël, mikronjësi ose PF. Sipas ligjit, këto njësi ekonomike, duhet të hartojnë dhe publikojnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e Performancës dhe shënimet shpjeguese. Disa nga këto njësi kanë hartuar dhe publikuar, në mënyrë vullnetare, edhe pasqyrat e tjera Financiare.

**Tabelë 2. Informacion mbi plotësimin e detyrimit për hartimin e pasqyrave financiare**

<b>Pasqyrat Financiare</b>	<b>Detyrim ligjor</b>		<b>JO Detyrim ligjor</b>	
	<b>PO</b>	<b>JO</b>	<b>PO</b>	<b>JO</b>
Pozicioni Financiar	40	1		
Performanca	41	0		
Të ardhura Gjithëpërfshirëse	9	0	20	12
Fluksi i mjeteve Monetare	8	1	7	25
Ndryshimi i Kapitalit	8	1	18	14
Raporti ecurisë së veprimtarisë	6	3	2	30
Raporti jofinanciar			3	38



Kriteret, në vitin 2020, për t'u audituar i plotësojnë 26 (njëzetegjashtë) njësi ekonomike, ndër të cilat vetëm 5 (pesë) janë shprehur në shënime shpjeguese se janë audituar por vetëm 3 (tre) prej tyre e kanë të publikuar (të shfaqur në portal) Raportin e Audituesit.

### **Problematika të monitorimit të Raporteve të tjera që shoqërojnë Pasqyrat Financiare**

Nga **41 (dyzetënjë)** njësi ekonomike që kanë hartuar dhe publikuar Pasqyrat Financiare, detyrimi (ose jo) për të përgatitur raportet e tjera që shoqërojnë pasqyrat financiare rezulton i përmbushur si më poshtë:

*Tabelë 3. Zbatueshmëria e detyrimit për hartimin e raporteve jofinanciare*

Raportet e tjera	Njësi ekonomike që plotësojnë kriteret		Njësitë ekonomike që nuk plotësojnë kriteret
	PO	JO	
<i>Dorëzuar</i>			
Raporti i ecurisë së veprimtarisë	7	3	31
Raporti jofinanciar	3	3	35
Raporti i drejtimit të brendshëm	2	6	33
Raportimi i pagesave për institucionet shtetërore	4	7	30

### **Problematika të monitorimit të përgatitjes dhe publikimit të shënimeve shpjeguese**

Sipas ligjit Nr25/2018 të gjitha njësitë ekonomike në shënimet shpjeguese duhet të paraqesin:

1. numrin mesatar të punëmarrësve gjatë periudhës raportuese por në totalin prej **41 (dyzetënjë)** njësi ekonomike që kanë publikuar Pasqyrat Financiare, vetëm **12 (dymbëdhjetë)** njësi ekonomike kanë deklaruar numrin e punonjësve;
2. shumën e pagave/shpërblimeve për periudhën raportuese të anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikqyrëse por në totalin prej **10( dhjetë)** njësi ekonomike që

rezulton se e kanë këtë detyrim, vetëm **2 (dy)** njësi ekonomike kanë bërë korrekt deklarimin;

- tarifat gjithsej të paguara për çdo lloj auditimi, ligjor apo dhënie të sigurisë por nga **5 (pesë)** njësi ekonomike të audituara vetëm **1 (një)** njësi ekonomike ka deklaruar pagesën e bërë për audituesit ligjor;

Gjatë monitorimit të shënimeve shpjeguese u vërejt se:

- **9 (nëntë)** njësi ekonomike nuk kanë publikuar shënime shpjeguese;
- **28 (njëzetetë)** njësi ekonomike nuk i kanë të plota shënimet shpjeguese;
- **4 (katër)** njësi ekonomike i kanë të plota shënimet shpjeguese, ndër të cilat një njësi (sha) është në likuidim dhe një njësi tjetër (shpk) nuk ka aktivitet për vitin 2020

**Tabelë 4. Zbatueshmëria e detyrimit për hartimin e shënimeve shpjeguese**

*(klasifikimi sipas madhësisë)*

Shënime Shpjeguese	Total Njësi	E Madhe	E Mesme	E Vogël	Mikronjësi	PF
Pa shënime shpjeguese	9	1	1	7		
Jo të plota	28	3	2	18	2	3
Të plota	4	1	1	2		
<b>TOTALI</b>	<b>41</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>27</b>	<b>2</b>	<b>3</b>

**Tabelë 5. Zbatueshmëria e detyrimit për hartimin e shënimeve shpjeguese**

*(klasifikimi sipas formës juridike)*

Shënime Shpjeguese	Total Njësi	SHPK	SHA	PF
Nuk kanë shënime shpjeguese	9	8	1	
Jo të plota	28	24	1	3
Të plota	4	1	3	
<b>TOTALI</b>	<b>41</b>	<b>33</b>	<b>5</b>	<b>3</b>

Për **28 (njëzetetë)** njësitë ekonomike që kanë publikuar shënime shpjeguese jo të plota, më poshtë paraqitet një përmbledhje referuar gjetjeve për secilin prej standardeve :

*Tabelë 6. Respektimi i kërkesave për hartimin e shënimeve shpjeguese (sipas SKK-ve)*

Standardet	PO	JO	PO ne %
<b>SKK1</b>	28		100%
<b>SKK2</b>	18	10	64%
<b>SKK3</b>	2	24	7%
<b>SKK4</b>	13	7	46%
<b>SKK5</b>	13	13	46%
<b>SKK6</b>		1	
<b>SKK7</b>		3	
<b>SKK8</b>	21	7	75%
<b>SKK9</b>			
<b>SKK10</b>			
<b>SKK11</b>	14	14	50%
<b>SKK12</b>	21		100%
<b>SKK13</b>	1		100%
<b>SKK14</b>	1		100%

*Shënim! Në përcaktimin e të dhënave në tabelë nuk i është bërë referencë atyre pasqyrave ku zëri/zërat nuk janë paraqitur në pasqyrë.*

Një gjetje shumë e rëndësishme është se pjesa më e madhe e njësive ekonomike, edhe pse kanë paraqitur aktive financiare afatshkurtra apo afatgjata, nuk kanë dhënë shënime shpjeguese në lidhje me SKK3 –Instrumentet Financiare. Në shënimet shpjeguese nuk ka asnjë informacion në lidhje me kolateralin, huanë afatgjatë p.sh, afatet, norma e interesit, maturimi, grafiku i ripagimit dhe kufizimet që instrumenti i borxhit i imponon njësisë. Po kështu nuk ka informacione në lidhje me huatë të marra/dhëna nga/tek Ortaku.

❖ *Gjetje nga monitorimi i pasqyrave financiare të hartuara për vitin 2021*

Në gjashtëmujorin e dytë janë monitoruar pasqyrat financiare të 73 njësive ekonomike. Pasqyrat financiare janë siguruar nga faqja zyrtare e QKB-së. Përzgjedhja e njësive ekonomike është bërë në mënyrë të rastësishme

Forma juridike e njësive të kontrolluara është: 65 (gjashtëdhjetëepesë) njësi ekonomike me status SHPK dhe 8 (tetë) njësi ekonomike me status SHA Ky klasifikim është bërë duke u bazuar në Ekstraktet Historike të subjekteve.

Nga 73 (shtatëdhjetëetë) njësi të marra në shqyrtim:

- 61 (gjashtëdhjetëenjë) njësi ekonomike kanë hartuar dhe publikuar pasqyrat financiare për vitin 2021 sipas SKK-ve, SNRF-ve apo SKK 15;
- 12 (dymbëdhjetë) njësi ekonomike nuk i kanë të publikuara pasqyrat financiare në QKB.

**Tabelë 7. Zbatueshmëria e detyrimit për publikimin e pasqyrave financiare**

*(klasifikimi sipas formës së organizimit)*

	<b>Totali</b>	<b>SHPK</b>	<b>SHA</b>
Nuk kanë publikuar PF në QKB	12	8	4
Kanë publikuar PF në QKB	61	57	4
<b>Totali njësive të monitoruara</b>	<b>73</b>	<b>65</b>	<b>8</b>

Nga 61 (gjashtëdhjetëenjë) njësi ekonomike që kanë publikuar pasqyrat financiare:

- 8 (tetë) njësi ekonomike zbatojnë SNRF-të;
- 52 (pesëdhjetëedy) njësi ekonomike zbatojnë SKK 1-14;
- 1 (një) njësi ekonomike zbaton SKK 15;

**Tabelë 8. Standardet e zbatuara nga njësitë ekonomike**

*(Klasifikimi sipas madhësisë)*

Standardet e zbatuara	Total /Njësi Ekonomike	Madhe	Mesme	Vogël	Mikronjësi
SNRF	8	8			
SKK	52	4	19	21	8
SKK15	1				1
<b>Totali njësive ekonomike</b>	<b>53</b>	<b>4</b>	<b>19</b>	<b>21</b>	<b>9</b>

Në totalin e njësive ekonomike të monitoruara, 12 (dymbëdhjetë) njësi ekonomike që nuk kanë publikuar pasqyrat e tyre financiare në portalin e QKB-së:

- **10 (dhjetë)** njësi ekonomike e kanë patur detyrim ligjor publikimin e pasqyrave në QKB dhe nuk e kanë respektuar. Forma juridike e tyre është: **7 (shtatë)** njësi ekonomike me status SHPK, **3 (tre)** njësi ekonomike me status SHA
- **1 (një)** njësi ekonomike ka masën e sekuestros, forma juridike SHA;
- **1 (një)** njësi ekonomike ka pezulluar aktivitetin pa afat, forma juridike SHPK;

### **Problematika gjatë monitorimit të pasqyrave financiare 2021**

Nga 61 (gjashtëdhjetënjë) njësi ekonomike që kanë hartuar dhe publikuar Pasqyrat Financiare rezulton:

**Tabelë 9. Klasifikimi i njësive ekonomike sipas madhësisë**

<b>Totali i njësive Ekonomike</b>	<b>61</b>
Njësi ekonomike e Madhe /Mesme	31
Njësi ekonomike biznes i vogël, Mikronjësi	30

*Shënim: Nga 19 (nëntëmbëdhjetë) njësi ekonomike të mesme , 2 (dy) prej tyre nuk kanë dhënë numrin e punonjësve pra nuk mund të shprehemi nëse plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar në*

*njësi ekonomike të mëdha. Nga 21 (njëzetënjë) njësi ekonomike “e vogël” , 4 (katër) prej tyre nuk kanë dhënë numrin e punonjësve pra nuk mund të shprehemi nëse plotësojnë kriteret për t’u klasifikuar në njësi ekonomike “të mesme”.*

Sipas ligjit njësitë ekonomike të mesme dhe të mëdha duhet të hartojnë dhe publikojnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të kapitalit. Në këtë kampion të monitoruar, disa njësi nuk i kanë hartuar dhe publikuar të gjitha pasqyrat financiare.

**Tabelë 10. Zbatueshmëria e detyrimit për hartimin e pasqyrave financiare**

*(njësi ekonomike të mesme dhe të mëdha)*

<b>Njësi ekonomike të Mëdha / Mesme</b>	<b>PO</b>	<b>JO</b>
Pozicioni financiar	31	
Performanca	30	1
Të ardhura gjithëpërfshirëse	30	1
Fluksi i mjeteve monetare	26	5
Ndryshimi kapitalit	26	5

Ndërsa në totalin e **30 (tridhjetë)** njësive ekonomike të monitoruara me status njësi ekonomike e vogël ose mikronjësi, në lidhje me përmbushjen formale të detyrimit për pasqyrat e publikueshme rezulton se:

**Tabelë 11. Zbatueshmëria e detyrimit për hartimin e pasqyrave financiare**

*(njësi ekonomike të vogla dhe mikro)*

<b>Njësi ekonomike biznes i vogël dhe mikronjësi</b>	<b>PO</b>	<b>Plotësuar vullnetarisht</b>
Pozicioni Financiar	30	
Performanca	30	
Të ardhura Gjithëpërfshirëse		27
Fluksi i Mjeteve Monetare		12
Ndryshimi i Kapitalit		13

Të gjitha njësitet ekonomike të monitoruara që kanë publikuar në QKB Pasqyrat Financiare në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Sipas ligjit 25/2018, dt 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 23 pika 3, pasqyrat financiare nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare. Nga monitorimi i njësive që kanë hartuar dhe publikuar pasqyrat financiare u konstatua se jo të gjitha njësitet ekonomike e kanë zbatuar këtë pikë të ligjit.

**Tabelë 12. Zbatueshmëria e detyrimit për nënshkrimin e pasqyrave financiare**

	<b>Në përputhje me ligjin</b>	<b>Firmosur vetëm nga Administratori</b>	<b>Pa firmë /vule</b>	<b>Totali</b>
Njësi ekonomike e madhe	6	2	4	<b>12</b>
Njësi ekonomike e mesme	12	6	1	<b>19</b>
Njësi ekonomike e vogël	9	10	2	<b>21</b>
Mikronjësi	7	2		<b>9</b>
<b>Total</b>	<b>34</b>	<b>20</b>	<b>7</b>	<b>61</b>

